

VENDIM
Nr. 83, datë 8.2.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 687, DATË 5.10.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË
KONFISKUARA, SI DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË
SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15, pika 2, dhe 34, pika 2, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, të nenit 22, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 687, datë 5.10.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në paragrafin e bazës ligjore dhe kudo në vendim, titulli i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të jetë “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

2. Pika 4, e kreut I ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës.”.

3. Pika 5, e kreut I, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Agjencia drejtohet nga kryeadministratori. Marrëdhëniet e punës së kryeadministratorit rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.”.

4. Pika 2.3, e kreut VII, ndryshon si më poshtë vijon:

“2.3. Procedurat e kryerjes së shpenzimeve realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.”.

II. Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi